

PLAMMAL-3D

Sistem për mbrojtje zjarrfikëse për konstruksione çeliku.

Plammal-3D grund-lyerje epukside antikoroze.

Plammal-3D ekspansiv-lym akril bazë ekspandil mbi bazën e tretësve.

Plammal-3D llak lyerje mbrojtëse përfundimtare

Sfera e përdorimit:

Për mbrojtje zjarrfikëse të konstruksioneve të jashtme dhe të brendshme prej çeliku, elemente dhe pajisje në objekte si: qendra tregtare dhe hotele, termo elektrana, hidro elektrana, qendra nukleare, salla dhe magazina prodhuese, objekte sportive, objekte ushtarake etj. Përparësitë e sistemit janë që mundëson shikueshmëri të konstruksionit, vendosje të thjeshtë të shtresave të sistemit për spërkatje, furçë ose furçë rrotulluese, është i thjeshtë për mirëmbajtje dhe kontroll të konstruksionit, rezistent ndaj ujit, rezistencë kimike dhe mekanike.

Përshkrim i Sistemit:

- Sistemi për mbrojtje zjarrfikëse Plammal-3D përbëhet prej tre shtresave të lyerjeve të cilat janë parashikuar të funksionojnë në të gjitha kushtet e eksploatimit.
- Plammal-3D grund është lyerje antikoroze e prodhuar mbi bazën e rrëshirës epokside. Ka athezion të shkëlqyer për bazën prej çeliku dhe rezistencë të lartë të dëmtimeve mekanike dhe kimike. Si e tillë përfaqëson bazë adekuate për vendosjen e shtresës tjetër të sistemit, Plammal-3D ekspansiv.
- Plammal-3D ekspansiv është lyerja bazë e këtij sistemi zjarrfikësi. Funksionon në atë mënyrë që në temperaturë prej rreth 160 °C fillon të ekspandohet duke rritur vëllimin e vet për 10-20 herë, ndërkaq formon shtresë me strukturë sfungjeri e cila funksionon si termo izolim rreth elementit të çelikut.
- Plammal-3D llak është lyerje mbrojtëse dekorative përfundimtare e prodhuar mbi bazën e rrëshirës akrilate. Roli themelor është të mbrojë lymn ekspansiv nga ndikimet atmosferike. Prodhet në shumë ngjyra sipas ton kartë.

Karakteristikat teknike:

Plammal-3D grund

Pamja:

Komponent A: masë e kuqe viskoze

Komponent B: masë transparente viskoze

Pesha specifike

Komponent A:

Komponent B:

Plammal-3D ekspansiv :

Pamja:

Pastë bardhë-gri

Pesha specifike:

1,3-1,4 kg/dm³

Plammal-3D llak:

Pamja: Masë e ngjyrosur pastore e kuqe viskoze

Pesha specifike

1,3-1,4 kg/dm³

Përgatitja e bazës:

Baza prej çeliku duhet të jetë e pastër dhe pa yndyra, e peskuar në nivel pastërtie që përshtatet me standardet BS 7079 pjesa A1 me shkallë përgatitje SA 2½ ose DIN 2. në rastet kur baza përgatitet me dorë me furçë çeliku deri në nivel SA 2. Sipërfaqet e galvanizuara përgatitet me vendosjen e "wash primer".

Kushte Gjatë Inkorporimit:

Të gjitha shtresat e sistemit Plammal-3D inkorporohen në temperaturë midis 10 - 35 °C të rrethimit dhe të bazës. Lagështia relative e rrethitës të jetë nën 70%. Gjatë vendosjes së shtresave si edhe në periudhën e lidhjes është e nevojshme të mbrohen nga lagështira.

Plammal-3DGrund

Lyerja vendoset mbi konstruksionin e çelikut jo më vonë se 4 orë pas përgatitjes së bazës. Lyerja është prodhuar mbi bazën e rrëshirës epokside si dy komponent. Përgatitjet me përzierjen e komponentit A dhe B në raportin e dhënë në ambalazh (dërgohet në sete me raport të definuar). Inkorporimi kryhet me furçë ose furçë rrotulluese. Trashësia e thatë për një lym është 50-70µ. Koha e lidhjes është 2 orë në 20°C.

Plammal-3D Ekspansiv

Lyerje një komponent që para vendosjes duhet të përzihet mirë deri në homogjenizim të plotë. Vendosja kryhet me furçë, furçë rrotulluese ose me spërkatje (aerless pompë). Vendosja kryhet në më shumë shtresa, deri në trashësinë e nevojshme sipas kohëzgjatjes së kërkuar të mbrojtjes zjarrfikëse. Trashësia e thatë e një shtrese është deri në 400 µ. Shtresa e parë vendoset minimum 24 pas vendosjes së grundit. Kohëzgjatja midis dy lyerjeve prej Plammal-3D ekspansiv është 6-12 orë varësisht nga temperatura dhe lagështira.

PLAMMAL-3D-varnish

Lyerje një komponent që para vendosjes duhet të përzihet mirë deri me homogjenizim. Vendosja kryhet me furçë, furçë rrotulluese ose me spërkatje. Vendoset 24 pas vendosjes së shterës së fundit të lymit ekspansiv. Trashësia e thatë e një shtrese është deri në 100-150 µ. Gjatë punës me të tre lyerjet e sistemit Plammal-3D përdoret RADHUES P. Vegla pastrohet menjëherë pas përdorimit.

Kontroll i trashësive të vendosura të lyerjeve:

Leximi i trashësisë së shtresës së thatë të lymit ekspansiv (nga i cili varet niveli i mbrojtjes) kryhet pas lidhjes së plotë (tharje) të shtresës së fundit të vendosur. Matja kryhet me instrumente standarde elektro magnetike ose ultra zëri. Llaku Plammal-3D vendoset pasi të konstatohet trashësi e kënaqshme e lymit ekspandues (trashësi të nevojshme për mbrojtje përkatëse zjarrfikëse janë dhënë në tabelën 1).

Efekte Nga Inkorporim Jo I Drejtë:

Nëse baza nuk është përgatitur drejtë sipas kushteve të rekomanduara paraqitet rreziku Plammal-3D grund të mos ngjitet mjaftueshëm me bazën e çelikut me çka më vonë mund të vijë në rënien e gjithë sistemit. Te tre lyerjet e sistemit janë kompatible midis tyre në raport me përbërjen dhe tretësit. Çdo ndryshim i cilës do prej shtresave me prodhim tjetër e çon sistemin në rrezik të humbas funksionin e tij ose në rënie të tij të shpejtë. Vëmendje e veçantë duhet tu kushtohet kushteve të temperaturës së ambientit dhe të çelikut në periudhën e vendosjes. Shtresat duhet të vendosen në diapazonin e parë të temperaturës.

Harxhim:

- Plammal-3D grund 150/200g/m²
- Plammal-3D ekspansiv (tabela 1)
- F/A faktor i prerjes së profilit të çelikut
- F-perimetër i prerjes së çelikut
- A-sipërfaqja e prerjes së çelikut
- d.s.f.- trashësia e shtresës së thatë
- a-vendosje me furçë
- b-vendosje me spërkatje
- Plammal-3D llak 150/200 g/m²

Paketim:

- Plammal-3D grund sete prej 5 dhe 18 kg.
- Plammal-3D ekspansiv kova metalike prej 4 dhe 20 kg.
- Plammal-3D llak kova metalike prej 4 dhe 20 kg.
- RADHUES P kova plastike prej 1 dhe 5 kg.

Magazininim:

Në paketim origjinal në temperaturë prej min. 5°C deri në 35°C. Afati i përdorimit: 9 muaj.

F/A	15 min.				30 min.				60 min.			
	d.s.f mm	Potr. kg/m ²	post.pun.		d.s.f (mm)	Potr. kg/m ²	post.pun.		d.s.f	Potr. kg/m ²	post.pun.	
			a	b			a	b			a	b
0-100	0,30	0,70	1	1	0,60	0,30	2	1	0,75	1,70	3	2
100-150	0,50	1,10	2	1	0,60	1,30	2	1	0,75	1,70	3	2
150-200	0,55	1,20	2	1	0,60	1,30	2	1	1,50	3,30	4	2
200-250	0,65	1,50	2	1	0,75	1,70	3	2	1,80	4,00	5	3
250-300	0,75	1,70	3	2	1,20	2,60	4	2	2,20	5,00	6	3

Rrezik për shëndetin:

Është e nevojshme ajrosje e vazhdueshme e ambientit në të cilin vendoset sistemi. E detyrueshme të përdoren doreza mbrojtëse, syze dhe maska. Nëse materiali spërkat në sy duhet menjëherë të shpëlahet me ujë të pastër dhe të kërkohet ndihmë mjekësore.

Zjarr: Materialet të përdoren me kujdes sepse përbajnë tretës që ndizen lehtë.

Pastrim dhe deponim:

Pastrimi mbetjeve të lyerjeve prej Plammal-3D sistem është me RADHUES P që është i paraparë për sistemin. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas rregullave lokale dhe rregullativës për atë lloj mbeturine.